

**VENDIM**  
**Nr. 196, datë 3.8.2022**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 154, DATË 13.6.2022 “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË ‘ALBESP TRADING & CONSULTING’ SHPK”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/4 prot., datë 26.7.2022, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 13.6.2022 “Mbi dhënie n e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e ‘AlbEsp Trading & Consulting sh.p.k.’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 154, datë 13.6.2022, vendosi dhënie n e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. Në pikën 2, të këtij vendimi, është përcaktuar se shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. duhet të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 257/7 prot., datë 17.6.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 257/8 prot., datë 12.7.2022, shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, ku janë reflektuar ndryshimet përkatëse, sikurse përcaktuar dhe në autorizimin e ERE-s.

- Me depozitim n e këtij dokumenti rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 154, datë 13.6.2022.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 154, datë 13.6.2022 “Mbi dhënie n e autorizimit nga ere për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**